




Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, në bazë të neneve 23 dhe 24 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës: 29.3.2017, nenit 10, pika 1 dhe 2 e Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për transparencë në komuna dhe nenit 7 të Rregullores Komunale për Transparencë NR.03/2019, Kryetari i Komunës, në bashkëpunim me Zyrën për Informim, bën:

**NJOFTIMIN
PËR
TAKIMIN E DYTË PUBLIK TË KRYETARIT**



Njoftohen të gjithë qytetarët e Komunës së Rahovecit, grupet e interesit dhe palët e tjera të interesuara, se Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, organizon takimin e dytë publik me qytetarë për punën e tij gjatë vitit 2023.

Takimi publik me qytetarë do të mbahet më datë: **20.12.2023 (e mërkurë), në orën 10:30**, në sallën e Kuvendit Komunal në Rahovec. Në këtë takim do të keni mundësi të njiheni me punën e qeverisë komunale gjatë vitit 2023 dhe zhvillimet aktuale në Komunë.

Po ashtu qytetarët pjesëmarrës në takim mund t'i bëjnë pyetje dhe komente ekzekutivit të Komunës për të gjitha temat të cilat atyre u interesojnë.

Komentet dhe sugjerimet e juaja, mund t'i dërgoni deri më datë: **19.12.2023** në orën **16:00**, në e-mailat: ali.morina@rks-gov.net, blerta.gashi@rks-gov.net, dhe Ardit.Halilaj@rks-gov.net.

Jeni të mirëpritur!

6.12.2023

